

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"FABER ALB" SH.P.K.**

**KREU I**  
**Ortakët dhe Baza ligjore**

Sot, në datën 30.07.2019 (dy mijë e nentëmbëdhjetë) ne, personat e mëposhtem:

- **ERALD DELJALLISI**, i biri i Xhemal-it, lindur me 12.03.1982 ne Tirane, banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga leternjoftimi (ID) me nr. personal: I20312071V.
- **FABJAN MIOLLI**, i biri i Agron-it, lindur me 11.02.1986 ne Tirane, banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. personal: I60211067M.

në cilësinë e "Ortakëve Themelues", me vullnet të lire të plotë e në bazë të nismës së lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërise, Kodin Civil në fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit", vendosi të themelojë shoqërinë tregtare, me perjegjësi të kufizuar, me emërtimin **"FABER ALB" SH.P.K.**

**KREU II**  
**Kuotat, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1**

**Emri dhe Ortakët**

- 1.1 Shoqëria është e organizuar dhe funksionon sipas formës "shoqëri me perjegjësi të kufizuar" dhe mban emrin **"FABER ALB" SH.P.K.**
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me perjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria **"FABER ALB" SH.P.K.** do të ketë objekt veprimtarie:

- Projektim, mbikeqyrje, kolaudim, vleresim te pasurive te paluajtshme, konsulencë dhe asistence teknike, juridike e ekonomike te projekteve, tenderave, kontratave, etj ne fushen e ndertimit dhe infrastruktura.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat 25 vjet.
- 3.2 Shoqëria **"FABER ALB" SH.P.K.** gjëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar te QKB-së.

**Neni 4**

**Zyra Qendrore**

- 4.1 Zyra qëndrore e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. "Bardhyl", Pall.11/b, shk.2, Ap.2, Tiranë, ne pasurine e paluajtshme me nr.pasurie. 5/222+1-2, vol. 34, faqe. 217, zk. 8370.
- 4.2 Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqesimi edhe në qytete të tjera, brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së

Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e kërkuar në fuqi sipas juridiksionit të vendit përkates.

### KREU III

#### Neni 5

##### Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10'000 lekë (dhjetë mijë) i formuar në masë të plotë nga kontributet e ortakëve dhe i ndarë në dy kuota me vlerë nominale sipas ndarjes me poshte. Çdo kuotë njësie ka të drejtën e (1) një vote. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si më poshtë:
- Ortaku themelues **ERALD DELJALLISI**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5'000 lekë (pese mijë) që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - Ortaku themelues **FABJAN MIOLLI**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 5'000 lekë (pese mijë) që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.3 Kontributet sa më sipër janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga ana e ortakëve të shoqërise.

#### Neni 6

##### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të cilësuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e cilësuar 3/4 (tre të katërtat) e votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.
- 6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e cilësuar të votave 3/4 (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që të respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqërite Tregtare.

### KREU IV

#### Neni 7

##### Kuotat dhe Kalimi i Kuotave

- 7.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndërmjet paleve.
- 7.2 asnje ortak nuk mund te disponoje te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave perkatese dhe /ose nuk mund te tjetersoje keto kuota nese nuk ka shlyer te gjitha detyrimeet qe rrjedhin nga zoterimi i tyre.

#### Neni 8

##### Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, bashkezoteruesit e mbetur gjalle dhe, ne rastin kur eshte zoterues i vetem ose një bashkezoterues i vetem i mbetur gjalle, trashegimtaret e tij Jane te vetmit persona te cilet shoqeria i njeh si titullare te kuotes te tij. Por ne asnje rast, ky fakt nuk e cliron pasurine e ortakut te vdekur nga detyrimet qe lidhen me kuoten qe ka pasur ne zoterim i vetem ose bashkerisht.

### Neni 9

#### Kerkesa per te paguar kuotat e kapitalit dhe terheqja e kuotave te papaguar

- 1- Administratoret mund tu kerkojne ortakeve te paguajne kontributin e papaguar ne lidhje me kuotat e tyre dhe cdo ortak, ne varesi te marrjes se nje njoftimi prej, te pakten, katermbedhjete ditesh te plota, qe percakton kohen dhe vendin se ku duhet te behet pagesa, i paguan shoquerise shumen e kerkuar per kuotat e veta, si percaktohet ne njoftim.
- 2- Nese do te kete zoterues te perbashket e nje kuote, ata mbajne perjegjesi bashkerisht dhe vecmas per te permbushur shlyerjet e percaktuara ne thirrjet perkatese per pagese te kontributit te cilat lidhen me kete kuote.
- 3- Nese nje thirrje per pagese mbetet e papaguar pas mbarimit te afatit, Administratoret mund ti japid nje njoftim prej jo me pak se katembetdhjete ditesh te plota personit qe eshte perjegjes per pagesen, permes te cilit i kerkojne te paguaje shumen e papaguar se bashku me interesin qe mund te jete akumuluar. Ne njoftim jepet emri i vendit ku duhet bere pagesa dhe percaktohet se ne rast mosbatimi, kuotat me te cilat lidhet njoftimi per pagese do te anulohen.
- 4- Nese njoftimi nuk respektohet dhe pagesa nuk ekzekutohet edhe pas ktij njoftimi, atehere kuotat perkatese mund te terhiqen me vendim te Administratoreve dhe terheqja perfshin edhe te gjithe dividentet ose shumat e tjera te pagueshme ne lidhje me aksionet e terhequra dhe te papaguara deri ne momentin e terheqjes.
- 5- Ne baze te nje vendimi te Administratoreve (ose te Administratorit kur eshte nje Administrator) kuota ose kuotat e terhequra mund te shiten ose te rishperndahe.
- 6- Personi prej te cilit jane terhequr kuotat e kapitalit pushon se qeni ortak ne lidhje me kuotat e terhequra por vazhdon te jete perjegjes perpara shoquerise per te gjitha kontributet te cilat jane te pashlyera ne daten e terheqjes se tyre, plus interesin e llogaritur me normen e interesit te zbatueshem per keto kontribute perpara terheqjes.

### Neni 10

#### Kuotat, te drejtat dhe kufizimet

Cdo kuote mund te emetohet me te drejta ose kufizime te tila sic percaktohet ne vendimin e kualifikuar 3/4 (tre te katertat e votes) se Asamblese se Pergjithshme.

### Neni 11

#### Certifikatat e kuotave te kapitalit

Ortaku ne momentin e marrjes se pronesise se kuotave te kapitalit, fiton te drejten te marre pa pagese nje certifikate per te gjitha kuotat qe zoteron. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotat ne zoterim te perbashket te disa personave. Emrat e zoteruesve te perbashket renditen ne certifikaten e kuotes. Ky vertetim nuk ka natyren e letres me vlere.

Kreu IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 12

#### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme do te thirret nga administratoret te pakten njehere ne vit ne seline e Shoqerise ose ne cdo vend tjeter nese percaktohet ne njoftim.
- 12.2 Gjithashtu ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% perqind te votave ne asamblene e perjithshme te shoquerise mund ti drejtojen Administratoreve nje kerkese me shkrim ose nepermjet postes elektronike per te thirrur asamblene e perjithshme. Ne kerkesen drejtuar Administratoreve mund te perfshihen dhe ceshtjet e posacme te rendit te dites.

- 12.3 Asambleja e ortakeve do te thirret me ane te nje rjoftimi te shkruar te derguar nga Administratoret, rjoftim ky i cili duhet te merret nga te gjithe ortaket ose perfaquesuesit e tyre nepermjet nje letre rekomande, jo me pak se 7 dite perpara dates se caktuar te mbledhjes.
- 12.4 Ftesa per takimin e asamblese se ortakeve do te tregoj daten kohen dhe vendin e takimit si dhe ceshjet e rendit te dites dhe ne rastin e nje asambleje te zakonshme te ortakeve do te perfshije gjithash tu dhe pasqyrat financiare dhe raportin e administrimit.
- 12.5 Nese dita per mbledhjen e ardhshme te asamblese eshte vodosur ne takimin e fundit dhe te gjitha ortaket kane qene prezent, atehere do te gjykohet sikur rjoftimi eshte derguar.
- 12.6 Nese te gjitha ortaket jane prezente ne asamblene e ortakeve, atehere vendimet mund te merren dhe ne mungese te permbushjes se kerkesave formale te caktuara me siper nese te gjithe ortaket jane dakort.

Neni 13

#### Te drejtat e Asamblesë së Përgjithshme

- 1- Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendim-marres i Shoqerise e cila ka te drejte te marre vendime ne lidhje me te gjitha ceshjet e veprimtarise se saj.
- 2- Asambleja e Pergjithshme perbehet nga te gjithe ortaket
- 3- Vetem asambleja e ortakeve ka te drejte te vendose per sa me poshte:
  - a. ndryshime te Statutit.
  - b. Pranimin e ortakeve te rinj (pas rritjes se kapitalit apo transferimit te kuotave)
  - c. Vendimin mbi perjashtimin e nje ortaku ne perputhje me dispozitat perkatese ligjore
  - d. Te jape te drejta nenshkrimi dhe/ose mundesi zevendesimi per kuotat ne shoqeri
  - e. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit themeltar dhe/ose cdo lloj pagimi te pjesshem ose subvencion te dhene nga ortaket
  - f. Bashkimin, ndarjen, prishjen, dhe cdo lloj transferimi te shoqerise
  - g. Blerjen apo disponimin e interesit pjesemarres ne shoqeri shqiptare apo te huaja
  - h. Hapjen dhe mbylljen e degeve dhe perfaqesive
  - i. Miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit te shoqerive si dhe shperndarjen e fitimit.
  - j. Blereje, shitjen dhe dhenien peng te pasurive te paluajtshme.
  - k. Marrjen me qira, dhenie me qira ose dhenien e cdo te drejte per perdonimin e pasurive te paluajtshme dhe ndertesave
  - l. Te vendose per investimet
  - m. Te jape letra me vlere, te marre detyrimet, te leshoje garanci ose letra sigurie
  - n. Te percaktoje parimet e pergjithshme te politikave te shoqerise
  - o. Te jape dhe te heqe (revokoje) prokura ose autorizime per te vepruar ne emer te shoqerise
  - p. Te caktoje shperblimet per administratoret, te perfundoje kontratat e sherbimit me administratoret dhe nepunesit ekzekutive te shoqerise
  - q. Te jape alternativa, te drejta te ndarjes se fitimit vjetor, pagesave ne natyre, te drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtoreve dhe nepunesve ekzekutive te shoqerise
  - r. Te perfundoje marreveshje konsultimi dhe bashkepunimi
  - s. Caktimin e auditoreve, eksperteve kontabel dhe likuiduesve
  - t. Miratimin e rregullave te brendshme mbi administrimin
  - u. Ngritjen e padive kunder anetareve te organeve te Shoqerise apo ortakeve
  - v. Percaktimin e struktureve organizative dhe administrative te shoqerise

- w. Percaktimin e buxhetit vjetor
- x. Miratimin e cdo ceshje tjeter zgjidhja e se ciles i eshte rezervuar asamblese se ortakeve ne perputhje me ligjin dhe kete Statut.
- 4- Ne cdo rast asambleja e ortakeve do te kete te drejte te vendose mbi cdo ceshje qe tejkalon aktivitetin e perditshem te shoqerise.

#### Neni 14

##### Punimet e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 14.1 Asambleja e Pergjithshme cakton nje Kryetar per te drejtuar punimet e mbledhjes dhe nje person per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes. Ky vendim merret me shumice te thjeshte.
- 14.2 vendimet duhet aprovuar permes votimit te Asamblese merren me vote te hapur, nese, perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk eshte kerkuar ne menyre te iregullt nje votim i fshehte. Votimin e fshehte mund ta kerkajo:
- a- Kryetari ose
  - b- nje ortak ose disa ortak qe perfaqesojne jo me pak se pese perqind te votave gjithsej te asamblese se pergjithshme.
- 14.3 Vendimet ne asamblene e ortakeve te cilat kerkojne nje shumice te zakonshme mund te merren vetem nese jane te pranishem ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave. Vendimet ne asamblene e pergjithshme te cilat kerkojne shumice te kualifikuar mund te merren vetem nese jane te pranishem ortaket te cilet zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.
- 14.4 Prokura duhet te jete e noterizuar dhe te paraqitet ne mbledhjen e ortakeve. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
- 14.5 Cdo ortak ka te drejte te therrase keshilltare ne mbledhjen e ortakeve, te cilet do te jene te detyruar te ruajne fshehtesine e mbledhjes.
- 14.6 Nese mbledhja e ortakeve thirret ne menyre te iregullt por nuk plotesohet numri i ortakeve te caktuar per te permbushur kuorumin, atehere asambleja do te thirret perseri ne perputhje me te njejtien procedure, por gjithmone jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite.

#### Neni 15

##### Votat e Ortakëve

- 15.1 Ne varesi te te drejtave ose kufizimeve te lidhura me kuotat, secila kuote e nje ortaku i cili si (individ) eshte i pranishem vete ose permes nje prokure perfaqesimi ose (si shoperi) eshte i pranishem permes perfaquesuesit te autorizuar ne menyre te iregullt ose permes nje prokure perfaqesimi ka te drejten e nje vote.
- 15.2 Asnje ortak nuk ka te drejten e votes ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme personalisht ose permes nje prokure perfaqesimi, ne lidhje me kuotat qe zoteron vete, nese nuk jane paguar teresisht kontributet nga ana e tij ne lidhje me kuoten ne fiale.
- 15.3 Kundershtimet e ngritura per plotesimin e kushteve nga ana e nje votuesi i behen ne kohe Kryetarit, vendimi i te cilil, eshte i forme se prere.
- 15.4 Do te aprovojen apo refuzohen vetem ato ceshje te cilat jane percaktuar shprehimisht ne rendin e dites per mbledhjen e ortakeve. Diskutimet mbi ceshje te ndryshme nga ato te rendit te dites mund te behen vetem nese te gjithe ortaket jasin pelqimin e tyre.

Neni 16

Proces verbali i mbledhjes se ortakeve

- 1- Per cdo mbledhje te ortakeve do e mbahet nje procesverbal. Prosesverbal duhet te mbaje daten, vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit dhe te mbajtesit te procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Nje kopje e procesverbalit do te pergetitet per shoqerine, nje per regjistrin tregtar dhe nje per secilin ortak. Prosesverbalit i bashkengjitet lista e pjesemarresve se bashku me aktin e thirrjes se asamblese se per gjithshme, kur eshte rasti.
- 2- Prosesverali do te firmoset nga kryetari dhe kunderfirmoset nga sekretari qe e mban ate, si dhe nga te gjithe pjesemarresit ne menyre fakultative.
- 3- Administratori eshte per gjegjes per ruajtjen e kopjeve te procesverbalit dhe shperndarjen e tij.

Kreu V

Administratori

Neni 17

Emërimi i Administratorit

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të janë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 17.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "FABER ALB" SH.P.K. **ERALD DELJALLISI**, i biri i Xhemal-it, lindur me 12.03.1982 ne Tirane, banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga leternjoftimi (ID) me nr. personal: I20312071V(për një afat 5 vjeçar, nga momenti i regjistrimit të këtij fakti pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit).

Neni 18

Kompetencat e Administratorit

- 18.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa më sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.
- 18.2 Pa u kufizuar sa më sipër, në menyrë të veçantë, Administratori ka këto kompenteca:
- a. Perfaqesimin e shoqerise kundrejt paleve te treta dhe shtetit
  - b. do të hapë llogari në emër të Shoqërisë më çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
  - c. marrjen e huave ne emer te Shoqerise dhe vendosjen e kushteve
  - d. perfundimin e marreveshjeve mbi dhenien e huave deri ne limitin e meposhtem
  - e. perfundimin e marreveshjeve me palet e tret, leshimin dhe marrjen e urdher pagesave
  - f. nenshkrimin e te gjithe dokumenteve, nxjerrjen e faturave, transferimet ne monedhe te huaj, flete ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve te shoqerise dhe pranimin e letrave me vlere nga palet e treta.
  - g. Mbledhjen e detyrimeve qe i takojne shoqerise, dhenien dhe marrjen e paradhenieve
  - h. Dhenien e moratoriumit debitoreve te shoqerise, heqjen dore nga padite qe vijnë si pasoje e marredhenieve te shoqerise me palet e treta dhe /ose pranimin e



- ketyre padivePunesimin dhe shkarkimin e stafit te shoqerise, percaktimin e pagave, shperblimeve dhe pagesave te stafit
- i. marrjen e masave paraprake per mbrojtjen e interesave te shoqerise, fillimin e padive dhe marrjen persiper te mbrojtjes se shoqerise ne rast ta padive kunder saj, administratoret mund te udhezojne avokatet te mbrojne shoqerine dhe mund te percaktojne shumen e shperblimit te tyre, administratoret kane te drejte te ngrene padi dhe ti terheqin ato, te nenshkruajne marreveshje gjyquesore, te mbyllin marreveshje arbitrazhim te caktojne arbitra, te terheqin padite e ngritura nga shoqeria dhe te nderprejne procedimet.
  - j. Administratoret kane te drejte marrin cdo vendim tjeter qe i takon aktivitetit te perditshem te shoqerise nga pikepamja e ligjit dhe ketij Statuti.
  - k. Mbledhjene e shpenzimeve te shoqerise
  - l. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e llogarive ne perputhje me ligjin dhe parimet e ligjit.
  - m. Administratoret jane pergjegjes per pergatitjen dhe nenshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare te shoqerise dhe kontrollin e tyre nga nje auditor i jashtem nese dicka e tille kerkohet nga ligji apo vendimi i ortakeve Thirrjen e mbledhjen e ortakeve, percaktimin e rendit te dites, monitorimin e perm bushjes se dispozitave qe kane lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbeldhjes se ortakeve per shpalljen e vendimeve te vecanta
  - n. Publikimin e shpalljeve te nevojshme perfshire dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare
  - o. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit te shoqerise
  - p. Marrin vendime mbi te gjitha ceshtjet e tjera qe lidhen me aktivitetin e brendshem te shoqerise dhe marrdheniet e saj te jashtme.

Cdo lloje pagese monetare, ekzekutim detyrimi i vleresueshem, te gjitha kontratat, veprimet financiare, dhenia e garancive apo te shit-blerja e pasurive te shoqerise, qe kalojne vleren 500'000 Leke, administratoret do te kene te drejte te veprojne vetem pas miratimit nga ana e Asamblese se Pergjithshme.

#### Neni 19

#### Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuau ose mund të vuajë nga çrrëgullime mendore;
3. ndodhet ose mund te ndodhet ne kushtet e pa-aftesise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. vdekje;
6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij.

#### Neni 20

#### Shperblimi i punes, perfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratoreve

- 20.1 Administratoret kane te drejte te marrin shperblim per punen e tyre, sipas nje vendimi te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme.

Kreu VI  
Prishja dhe njoftimet  
Neni 21

**21.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) me vendim te mbledhjes se asamblese se ortakeve
  - b) nepermjet bashkimit me një shoqeri tjeter.
  - c) mbibazen e një vendimi te gjykates dhe per rastet e parashikuara me ligj
  - ç) netegjitharastet e tjerateparashikuara me ligj.
- 21.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 21.3 Likuidimi i shoqerise dhe shperndarja e aseteve te saj do te behet ne perputhje me dispozitat ligjore.

**Neni 22**

**Njoftimet**

- 22.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 22.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotëruar të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

**Neni 23**

**Viti finanziar, bilacni, fitimet dhe humbjet**

- 23.1 Çdo dokument qe leshohet per dhe ne emer te shoqerise eshte i pavlefshem nese nuk mban vulen e saj.
- 23.2 Te gjitha marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me Kodin e Punes dhe cdo akt tjeter ligjor dhe nenligjor te zbatueshem te Republikës se Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim kohe pas kohe gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit te saj tregtar.
- 23.3 Viti finanziar zgjat 12 (dymbledhjete) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 23.4 Ne fund te cdo viti finanziar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, te cilet i dergohen per miratin Asamblese se zakonshme.
- 23.5 Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare ne fuqi, te azhornuar.

**NENI 24**

**FITIMI I SHOQERISE**

- 1- Fitimi neto i shoqerise do te shperndahet ne perputhje me pjeset e kapitalit ne shoqeri si me poshte:
  - 50 % e fitimit do ti shperndahet **ERALD DELJALLISI**
  - 50% e fitimit do ti shperndahet **FABJAN MIOLLI**.

- 2- Fitimi neto do te jete fitimi i shoqerise ne perputhje me pasqyrat vjetore financiare te miratuara pas zbritjes se te gjitha taksave dhe caktimit te rezervave ligjore. Bilanci i shoqerise do te miratohet nga asambleja e ortakeve dhe do te dorezohet ne organet tatymore perpara fundit te muajt Mars te vitit pasardhes.

NENI 25

DIVIDENTET

- 1- Pasi Asambleja e Pergjithshme ka verifikuar se aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj dhe se shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim, shoqeria, me ane te nje vendimi te kualifikuar, mund te shpallore dividende ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.
- 2- Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe u lidhen kuotave, te gjithe dividentet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per kuotat ne lidhje me te cilat paguhet dividendi.
- 3- Te gjithe dividendet perpjestohen dhe paguhen ne perpjestim me shumat e paguara per kuotat gjate pjeses ose pjeseve te periudhes ne lidhje me te cilat paguhet dividendi. Por nese, kuota emetohen me kushtin se merr dividendi duke filluar nga nje date e caktuar, atehere kuota ne fjalë merr dividend sipas ketij kushti.

NENI 26

Dispozita perfundimtare

- 25.1 Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimitarise se shoqerise. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.
- 25.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 kopje originale te njëjtë, me permbajtje dhe vlerë te njëjtë juridike, në gjuhën Shqip dhe u nenshkrua nga palët pa asnje rezevre.

- 25.3 Depozitimi i këtij Statuti e akt themelimi pranë QKB Tiranë, do te bëhet nga Administratori i "Faber ALB" Shpk., z. Erald Deljallisi.

Date 30 /07 /2019

ORTAKET THEMELUES

ERALD DELJALLISI

Erald Deljallisi  


FABJAN MIOULLI

Fabjan Mioli  


—

5